



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 33 .

Prishtinë, më 12.2.2019, në ora 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Xhelal Sveçla dhe Danush Ademi, zëvendëskryetarë, Kujtim Shala, Fadil Beka, Haxhi Shala, Rasim Selmanaj, Albert Kinolli, Mufera Shinik dhe Slobodan Petroviç.

Munguan: Igor Simiq, Jasmina Zhivkoviç, Sasha Mil, Zoran Mojsiloviç, Duda Balje dhe Veton Berisha, anëtarë.

Pjesëmarrës tjerë: Senad Karaahmetovic OSBE; Pleurat Kurti EUSR; Ndiriçim Çekaj KDI; Zijush Ahmeti KSZ dhe Celal Iliaz, Drejtorja për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

Personeli për mbështetjen e komisionit: Natasha Prica-Tishma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: **Xhelal Sveçla**, zëvendëskryetar i Komisionit.

Rend i ditës:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura me datë 28.1.2019 dhe 30.1.2019;**
3. **Formimi i grupeve të punës sipas Planit të punës së Komisionit, për vitin 2019;**
4. **Shqyrtimi i raportit plotësues për Projektligjin nr.06/L-088 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të ujit, me raport amendamente të Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor;**
5. **Të ndryshme.**

1. **Miratimi i rendit të ditës;**

Kryetari, konstatoi se rendi i ditës miratohet njëzëri, pa ndryshime.

2. **Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura me datë 28.1.2019 dhe 30.1.2019;**

Zëvendëskryetari, konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura me datë 28.2.2019 dhe 30.1.2019, pa vërejtje.

3. Formimi i grupeve të punës sipas Planit të punës së Komisionit, për vitin 2019;

Zëvendëskryetari, bazuar në organizimin e brendshëm dhe procedurave të punës së Komisioneve Parlamentare është edhe përpilimi i Planit të punës së Komisioneve për vitin 2019. Në kuadër të përgjegjësisë dhe angazhimeve të saja, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, e ka hartuar dhe miratuar Planin e Punës me datë 28.1.2019, me përfundim që i njëjti të ndryshohet dhe plotësohet, në fillim të muajit shkurt 2019.

Komisioni ka organizuar punëtorinë në Vila Gërmia, me datë 6.2.2019, me ç' rast janë inkorporuar propozimet e anëtarëve të Komisionit.

Pasi nuk pati diskutime shtesë, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, nxori këtë

Përfundim

Komisioni miratoi Planin e punës për vitin 2019, me ndryshimin dhe plotësimin e propozimeve të dhëna, me datë 6.2.2019.

Zëvendëskryetari, në fjalinë e tij tha se, formimi i grupeve të punës lidhur me monitorimin e ligjeve, do të caktohet në një takim tjetër, me mundësi që Komisioni të jetë në përbërje të plotë. Ky propozim, u miratua unanimisht nga anëtarët e Komisionit.

4. Shqyrtimi i raportit plotësues për Projektligjin nr.06/L-088 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të ujit, me raport amendamente të Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor.

Zëvendëskryetari, paraqiti për shqyrtim raportin plotësues të Projektligjit nr.06/L-088 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve. me raport amendamente të Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor.

Theksoi se komisioni funksional ka proceduar vetëm një amendament me dy propozime, njëri është propozuar nga Komisioni Funksional dhe propozimi i dytë nga GP 6+, i cili nuk është përkrahur nga komisioni funksional.

Fjalën për diskutim ua dha përfaqësuesve të GP 6+.

Albert Kinolli, me theks të veçantë tha se GP 6+ ka dërguar propozim amendament në komisioni funksional, ku flitet për nenin 20 të ligjit bazik, paragrafin 5, me propozim që të fshihet fjalia 'Objektet e Kultit' me qëllim që të mos faturohet pagesa e ujit për këto objekte, ndërsa kërkoi të miratohet propozimi i paragrafit 5.

Të njëjtit mendim e ndajnë edhe **Mufëra Serbica Shinik** dhe **Danush Ademi**, me ç' rast kërkuan nga anëtarët e këtij komisionit, që të marr përkrahjen propozimi i GP 6+, dhe të formulohet tekstin si në vijim:

5. Objektet përcjellëse administrative, faturohet në kategorinë e konsumatorëve shtëpiak, ndërsa objektet përcjellëse fitimprurëse faturohen sipas tarifës për konsumatorë komercial-industrial.

Zëvendëskryetari, lexoi propozim amendamentin A) i cili ka ardhur si rezultat i punës së Komisionit Funksional, me propozim që Neni 4, paragrafi 2, të ndryshohet me tekstin si në vijim:

Në nenin 20 të ligjit bazik, paragrafi 5, të ndryshohet si në vijim:

5, Objektet e kultit dhe objektet përcjellëse administrative, faturohet në kategorinë e konsumatorëve shtëpiak, ndërsa objektet përcjellëse fitimprurëse faturohen sipas tarifës për konsumatorë komercial-industrial.

Zëvendëskryetari, konstatoi se Komisioni do të votojë veçmas amendamentin A) të propozuar nga Komisioni Funkcional, dhe veçmas amendamentin B) të propozuar nga GP 6+.

Zëvendëskryetari, fillimisht hodhi në votim amendamentin B) të propozuar nga GP 6+.

Zëvendëskryetari, konstatoi se Komisioni me 3 vota Për, 5 vota Kundër dhe asnjë votë Abstenim, nuk miratoi propozimin e GP 6+.

Zëvendëskryetari, konstatoi se Komisioni me 5 vota Për, 3 vota Kundër dhe asnjë votë Abstenim, miratohet amendamenti A) i propozuar nga Komisioni Funkcional.

Pas përfundimit të diskutimeve, zëvendëskryetari konstatoi se komisioni me 5 vota Për, 3 votë Kundër dhe asnjë votë Abstenim, nxori këtë:

R e k o m a n d i m

Projektligji nr.06/L-088 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve., me amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe rekomandohet të procedohet për miratim në Kuvend..

5. Të ndryshme.

Zëvendëskryetari, në këtë pikë do të diskutohet lidhur me vizitën në KK të Zubin Potokut, e cila është caktuar të realizohet me datë 13.2.2019. Për organizimin e kësaj vizite janë angazhuar stafi mbështetës i Komisionit dhe në përkrahje të OSBE-së.

Anëtarët e Komisionit u deklaruan se kanë angazhime të shumta për këtë javë, dhe kërkuan që kjo vizitë të shtyhet për një ditë tjetër.

Pas konsultimeve, Komisioni doli me qëndrim, që të organizohet vizita në KK të Zubin Potokut, me datë 20.2.2019.

Mbledhja përfundoi në orën 13:30.

Përgatitur nga; Njësia mbështetëse e Komisionit

Nënkryetar i Komisionit

Xhelal Sveçla